



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 1

Rrogozhinë, më 20.01.2023 ora 14 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.275.Prot datë 17.01.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.16, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.12.2022.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Raport, “Mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar-Dhjetor 2022, si dhe vendimet të cilat nuk janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë”.
- 6- Shqyrtim dhe njohje të Planit Operacional Vjetor 2023-2024, “Për administrimin e pyjeve dhe të kullotave të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 7- Shqyrtim dhe njohje të Projekt- Studimit, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor, tokave bujqësore dhe inproduktive (PF) në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 8- Të ndryshme.
 - *Shqyrtim të kërkesës së znj. Zaje Hunçi.*
 - *Të tjera.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Petrit Haska, Reshit Kala, Anjeza Proshka, Sheqere Biba, Haqim Tosku, Avni Kasa, Fatmira Thartori, Agim Pepa, Lulzim Hasa, Margarita Dedej, Luan Sheshi, Erind Tosku, Mukades Gixhari.



Mungojnë :

Enver Memolla, Vojsava Pipa, Emiliano Aliu, Mejte Saliu, Alban Sula, Fatjon Biba, Alime Hoxha.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Andi Proshka - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vaditjes.
4. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
5. Ledian Hasani – Përgjegjës i Shërbimit Social.
6. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT, njëkohësisht kryetar i komisionit të posaçëm për tërmetin.
7. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 11 Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : z. Petrit Haska, Reshit Kala, znj. Anjeza Proshka, Sheqere Biba, Haqim Tosku, z. Avni Kasa, znj. Fatmira Thartori, z. Agim Pepa, z. Lulzim Hasa, znj. Margarita Dedej dhe Mukades Gixhari.

Kalojmë në leximin e “Verifikimit Ligjor” ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 27.12.2022.



- Mbledhjes i bashkohet Këshilltari z. Luan Sheshi.

Këshillit Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinë.

Vendimi nr .72. datë 27.12.2022 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2022 nga fondi i pushtetit vendor” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .73. datë 27.12.2022 “Për miratimin e Paketës Fiskale viti 2023 për Bashkinë Rrogozhinë” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .74. datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2023” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .75. datë 27.12.2022 “Mbi realizimin Faktik të Buxhetit 2022 për Bashkinë Rrogozhinë” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .76. datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Bashkinë Rrogozhinë” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .77. datë 27.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .78. datë 27.12.2022 “Për miratimin e Hartës së Plazhit Spille dhe Vilë Bashtovë, Bashkia Rrogozhinë, në zbatim të VKM, Nr.171, datë 27.03.2019 për miratimin e Rregullores “Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit“. Miratohet në parim referuar ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe VKM nr.171 datë 10.10.2022.

Vendimi nr .79. datë 27.12.2022 “Për dhënie ndihme financiare për shpenzime varrimi” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .80. datë 27.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Rrogozhinës Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .81. datë 27.12.2022 “Për miratimin e listës së nxënësve që vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Mesëm Profesional që përfitojnë bursë shteti për vitin shkollor 2022-2023” është në përputhje me ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Prefekt Afrim Qëndro.

Mukades Gixhari . Tani, para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës kemi një projektvendim shtesë të cilin e gjeni të fotokopjuar para gjithsecili, me titull “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor”, bëhet fjalë për dy familje shtesë. I keni parë?

Haqim Tosku . Pse vjen minutat e fundit, kush është arsyeja?



Ledian Hasani . Duke qenë se kërkesat janë bërë dje mendova që t'i kalonim këtë muaj që të mos prisim se janë familje që janë në vështirësi ekonomike të dyja.

Mukades Gixhari . Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim, këto dy emra shtesë dmth tek ndihma ekonomike? Dhe vota ime është pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit me Nr.288. Prot datë 18.01.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. E hedhim në votim. Kush është dakord me rendin e ditës? Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro pika e 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 2, “Miratim i procesverbalit Nr.16, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.12.2022”. E hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro pika e 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi bllok i ndihmës 6 %”. Fjala për përgjegjësin e zyrës së Shërbimit Social z. Ledian Hasani. Përsëndetje z. Ledian!

Ledian Hasani . Përsëndetje, si jeni? Gjithsej janë 18 familje përfituese me një fond prej 74 mijë lekësh të reja.

Mukades Gixhari . Ka ndonjë diskutim, në lidhje me këtë pikë? Atëherë meqenëse nuk ka diskutime e hedhim në votim. Kush është pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro pika e 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr. 1 . Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.287.Prot datë 18.01.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.



Mukades Gixhari . Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor”, këtu ku bëjnë pjesë dhe këto dy emrat që ne sapo i miratuam.

Ledian Hasani . Po i bashkoj të dy projektvendimet gjithsej janë 14 familje përfituese dhe fondi është 58 mijë lekë të reja për të 14 familjet, 12 familje janë tek projektvendimi i parë dhe dy familjet që janë tek projektvendimi që ju kam sjellë sot, janë nga i njëjti fond.

Mukades Gixhari . Ka diskutim? E hedhim në votim. Të dy projektvendimet. Të gjithë pro dhe vota ime shkon pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës, bashkë me projektvendimin me Nr.288.Prot datë 18.01.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.

Vendim nr. 2 . Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.260.Prot datë 16.01.2023 dhe me shkresë Nr.288.Prot datë 18.01.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Kalojmë në pikën pesë raport, “Mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar-Dhjetor 2022, si dhe vendimet të cilat nuk janë konfirmuar ligjrisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë”.

Raportin e keni të gjithë, për vitin 2022 në Këshillin Bashkiak Rrogozhinë janë marrë gjithsej 82 vendime i keni të pasqyruar në raport me titujt dhe datat përkatëse, të cilët janë përcjellë në Prefekturë, ku 79 prej tyre janë gjetur në përputhje me ligjin, kurse 3 të tjerë nuk janë konfirmuar ligjrisht nga ana e Prefektit të Qarkut. Në fund të raportit keni dhe arsyet ligjore që argumentojnë vendimet e pakonfirmuara sipas shkresës “Verifikimit Ligjor” të Prefektit të Qarkut. Gjithashtu që nga data 28.10.2022 mbledhjet e Këshillit transmetohen LIVE në faqen zyrtare të Këshillit në rrjetin social Facebook emërtuar “Këshilli Bashkiak Rrogozhinë”. Besoj e keni të qartë të gjithë?

Agim Pepa . Po.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim rreth kësaj pike? Në rregull atëherë kalojmë në pikën 6-të, Shqyrtim dhe njohje të Planit Operacional Vjetor 2023-2024, “Për administrimin e pyjeve dhe të kullotave të Bashkisë Rrogozhinë”. Fjala për përgjegjësin e sektorit të pyjeve Ing. Artur Kaja.



Artur Kaja . Përshëndetje të gjithëve! Duke ju uruar një vit të mbarë të gjithëve dhe sa më mirë qoftë ky vit për të gjithë. Plani operacional është një plan që hartohet çdo vit nga sektori i pyjeve pranë bashkisë tonë Rrogozhinë. Ky plan bazohet në ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Ligji “Për Pyjet” nr 57/2020 neni 17 gërma ”c” përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse për pyjet. Plani operacional vjetor është një dokument i planifikuar i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet në pyjet publike, buxheti i shtetit ose grante të ndryshme për realizimin e punimeve të përcaktuara ose të planifikuara nga planet e mbarështrimit të veprimtarive për zhvillimin e fondit pyjor. Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme si dhe për qëllime të tjera të parashikuara në këtë ligj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Ky plan synon në dy aspekte kryesore në mirëadministrimin dhe përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve dhe kullotave dhe të burimeve natyrore në territorin administrativ të bashkisë Rrogozhinë. Dhe në krijimin e traditës si dhe në përmirësimin e praktikave të trajnimit të pyllit bashkiak, shfrytëzimit sa më mirë racional të pyjeve dhe kullotave prodhimeve bujqësore dhe pyjore. Grumbullimin e bimëve medicinale sipas rregullave dhe kërkesave teknike brenda mundësisë së tyre të shfrytëzimit. Ky plan ka për qëllim rritjen e qëllimit të të ardhurave nga burimet natyrore, zhvillimin e tyre në shërbim të komunitetit dhe detajimin e investimeve për zhvillimin e tyre të mëtejshme. Plani vjetor operacional është përmbledhësi i mundësive konkrete burimeve kapaciteteve realizuese, menaxhuese mundësive financiare që do arrihen për një periudhë 1- vjeçare. Plani është i fiksuar në dy aspekte kryesore, burimin e të ardhurave për komunitetin e përdoruesit që ndikon në rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e jetesës së tyre dhe mundësinë e daljes në treg të prodhimeve të tjera që mund të shitet dhe të krijojë të ardhura për Bashkinë Rrogozhinë. Ky plan se nuk po e lexoj të gjithin parashikon të gjithë investimet që mund të kryhen nga sektori i pyjeve në pyje dhe të ardhurat që dalin nga këto që përmendëm më sipër nga shitja e prodhimeve të dyta dhënia e sipërfaqeve pyjore për përdorim etj. Këtu janë të parashikuara nuk e di çfarë mund të ... mund ta lexojmë të gjithë si të doni. Në qoftë se ka kohë ...

Mukades Gixhari . Doni që ta lexojë të gjithë z. Artur materialin që ka para?

Haqim Tosku . Po çfarë do lexojë... Një pyetje kisha, z. Turi sa të ardhura janë realizuar për vitin 2022?

Artur Kaja . Atëherë për vitin 2022 nga sektori i pyjeve janë realizuar afro 30 milionë lekë të vjetra.

Haqim Tosku . Po planifikimi për këtë vit sa është?



Artur Kaja . Pak a shumë është i njëjti.

Haqim Tosku . Po sikur nuk pashë në buxhet një planifikim të ardhurave nga pyjet. Muajin që shkoi u miratua buxheti nuk u diskutua fare nga të ardhurat e fondit pyjor.

Artur Kaja . Unë nuk e di si e kanë trajtuar por të ardhurat nga sektori i pyjeve janë 30 milionë, 30 pikë ca milionë lekë të vjetra.

Luan Sheshi . Nga vijnë këto?

Artur Kaja . Si e thashë dhe njëherë 25 milionë ose 28 milionë të vjetra janë nga dhënia në përdorim e fondit pyjor, 2 milionë të vjetra janë nga prodhimet e dyta edhe janë pastaj konvertime të ndryshme e të tjera që shkojnë 30 e ca milionëshi. Tani për 2023-in sasia e të ardhurave, këto janë të garantuara kjo 30 milionëshi por në qoftë se do jepen më shumë sipërfaqe ose do ketë më tepër prodhim, me e quajtur prodhime të dyta mund të kalojë mund të shkojë 35, 34 sipas asaj që ne mund të japim në përdorim mundësisë.

Luan Sheshi . Në buxhet sikur nuk e pashë.

Reshit Kala . Për pjesën e të ardhurave nga kryesorja e të ardhurave 25 milionë lekë të vjetra vijnë nga zona e Bedenit që është dhënë me qera. Unë shoh që kjo thotë që kjo do vazhdojë për një periudhë prej 10- vjeçar. Mirëpo unë tani po mendoj që ne kur e miratuar këtë... për sa vite e kemi miratuar?

Artur Kaja . Për 10 vjet aq e ka dhe ligji për dhënien maksimale të sipërfaqeve në përdorim, afati maksimal 10 vjet.

Reshit Kala . Po pas 10 vjetësh?

Artur Kaja . 10 vjet rinovohet ose jo, varet pastaj nga ecuria në qoftë se subjekti do jetë korrekt me shlyerjen e detyrimeve e të tjera, ose nuk ka një plan strategjik nga shteti.

Lulzim Hasa . Kur u dha kjo u fol për punëtorët që punonin, zotëria në fjalë i ka mbajtur 5 muaj dhe i ka përzënë. Kush është ky? Është thënë taksative këtu që ai që punon nga Bashkia në pyllin e Bedenit duhet të jetë nga aty, e ka mbajtur 5 muaj sot nuk i ka dhënë asnjë lek. Kush është ky? Tallet me fondin dhe pasurinë tonë.



Artur Kaja . Atëherë subjekti kur e ka marrë pyllin e ka marrë për këto qëllime që thamë dhe për punësimin e njerëzve. Tani për punën e rojeve është e drejta e tij që të vendosi një ose dy roje sepse atij i është dorëzuar me procesverbal ai pyll dhe ai mban përgjegjësi për çdo lloj dëmtimi që mund të bëhet në atë pyll.

Lulzim Hasa . Ore nuk është përzënë për shkelje se nuk ruajti, a më kupton? Ky jo vetëm që nuk punësoi ky ç'punësoi.

Luan Sheshi . Varet si ka lidhur kontratën.

Artur Kaja . Jo jo nuk është puna e kontratës...

Lulzim Hasa . Është vazhdim i kontratës së shtetit, ç'lidhje ka kontrata këtu?!

Artur Kaja . Subjekti në fillim fare siç e di ti e mori me vrull do punoj e të tjera...

Lulzim Hasa . Ai nuk ka bërë asgjë që kur e ka marrë, është penguar rrugës.

Artur Kaja . Më fal një sekondë ai e mori me vrull si e marrin një pjesë do marr, do bëj kushedi, por shteti ka ligje edhe që të bësh një veprimtari pavarësisht se ne kemi lidhur 1 kontratë i kemi dhënë një zyrë atij psh. Por që të marri prodhim ai duhet të blejë tani duhet të marri leje për të futur të tjera, ai akoma unë i kam shënuar në kontratë nuk do fillojë asnjë lloj punimi pa marrë lejen përkatëse nga KRRT-ja. Kështu që ai nuk ka filluar punimet akoma.

Lulzim Hasa . Është një lloj sikur ti të marrësh një në punë nga këto 5 muaj dhe ti thuash ik se nuk ti jap lekët për 5 muaj. A e kupton ku është qëllimi? Nuk e deshi puna e madhe erdhi në Qershor zotëri i dashur nuk të dua ty, ik. E ka mbajtur ka komunikuar deri në Tetor pastaj i ka thënë ik. Unë kërkoj që ai të vijë në Këshill Bashkiak të japi llogari. Të vijë këtu ta dëgjojmë ku e ka arsyen. Ne këtu na u tha me të madhe që ky do i shërbejë komunitetit do punësojmë, ai dhe atë që ti e ke pasur të punësuar e ç'punësoi. E hoqi nga puna e mbajti 5 muaj nuk i dha lekët. E di këtë muhabet pse duhet ti bëhesh përkrah atij ti, është pasuri e atij ajo jo e atij që vjen.

Artur Kaja . Nuk po i bëhem krah në qoftë se ai do kishte filluar punimet dhe ne do kishim mbyllur sytë atëherë po.

Lulzim Hasa . Lëri punimet, ti me çfarë tagri e ke ...atë që ka hequr ai. Ç'lidhje ka tani ai ishte roje atë objekt do ta ruaj dikush, e ka ruajtur ky. Nuk i tha kur e mori në Qershor që ti roje i



dashur ik se unë nuk kam nevojë për ty, po i tha ikte vinte komunikonte me këtë dhe në Tetor i tha ik se unë nuk të dua më.

Artur Kaja . Jo, ai ka thënë që do i japi në Mars lekët.

Lulzim Hasa . Kur në Mars?

Artur Kaja . Mars tani.

Lulzim Hasa . Unë kam punuar gjithë vitin ti bilancin e bën... nuk ka lidhje kjo Turi ai në qoftë se ka një sedër duhet të vijë të japi llogari këtu.

Haqim Tosku . Nuk kemi të drejtë të thërrasim firmën ne.

Lulzim Hasa . Kush është ky që tallet me pasurinë tonë është pasuria jonë ajo.

Artur Kaja . Ne akoma nuk po i japim leje.

Lulzim Hasa . Turi mos e përkrah atë mos kundërshto ka punuar 5 muaj tjetri ka fëmijë për të mbajtur, ka harxhuar naftë me makinë që ka shkuar atje. Ti i thua pas 5 muajsh ik ti ... ma argumento.

Artur Kaja . Unë jam në brendësi të këtij muhabeti dhe nuk do fillosh asnjë lloj punimi pa likuiduar personat atje.

Lulzim Hasa . Shihe ti mesazhin që i kam shkruar unë atij, të vijë të japi llogari.

Artur Kaja . Ai nuk do fillojë asnjë lloj punimi sepse të marrësh një objekt të paguash 25 milion për ta parë qoftë ai. Në qoftë se ai ka para për të hedhur në qoftë se e ka marrë për investim ai nuk do fillojë asnjë lloj punimi pa likuiduar këto.

Lulzim Hasa . Ai të vijë të tallet me pasurinë tonë kjo është absurde.

Artur Kaja . Ai deri tani nuk është tallur sepse nuk ka bërë asnjë punim, ai ka paguar 25 milion nuk ka bërë asnjë lloj punimi.

Lulzim Hasa . A e di mirë që aty po të mos ekzistojë nocioni që aty ka roje ai pyll ikën.



Artur Kaja . Ikën pylli i prishet kontrata atij, mbaroi ai muhabet.

Lulzim Hasa . Atij kush ja ka dhënë pyllin?

Fatmira Thartori . Kush e menaxhon pra nga Bashkia kush e kontrollon këtë pyll?

Lulzim Hasa . Nga Bashkia lidhet kontrata që të punësuarit që kanë qenë do jenë në punë plus zotëria kur të fillojë punimet do punësojë nga ajo zonë. Është kështu?

Artur Kaja . Po.

Lulzim Hasa . Ky ishte i punësuar ky e mbajti 5 muaj Tur i dashur dhe nuk i tha ditën që erdhi unë ty nuk të dua roje. Shumë qartë nuk e donte të ikte, e mbajti 5 muaj komunikonte me zotërinë e thirrte jam këtu jam aty. Ju tek atij pa një ëndërr të keqe në fund të Tetorit i tha unë ty nuk të dua më. Kush është ky?

Artur Kaja . Ai deri ditën që e ka mbajtur do e paguajë kokërr më kokërr, se ai ndryshe nuk merr asnjë lloj leje.

Lulzim Hasa . Vetëm bilanci i kooperativës bujqësore dilte në fund të vitit, në demokraci paguhet çdo kush merr rrogën do ushqejë fëmijët. Unë si anëtar i Këshillit Bashkiak ai të vijë këtu të japi llogari.

Mukades Gixhari . Znj. Fatmira Thartori.

Lulzim Hasa . Sepse ai është bërë pronar i pjesshëm mbi pasurinë tonë, që është dhe ai pronar ai që ka qenë roje, ka edhe ai pjesë tek ai pyll, kam dhe unë ke dhe ti. Kush është ky? Ky hiqet sikur me qenë ndonjë kapadai, unë jam kështu ambasada Amerikane, unë kam këtë shok kam atë mik .

Artur Kaja . Ambasada nuk na intereson fare.

Lulzim Hasa . Ashtu hiqet ai por nuk e ka pronën e babës.

Artur Kaja . Ai e ka marrë për një qëllim për të punuar kështu që deri tani ai nuk bërë një lopatë aty kështu që në moment që ai do kërkojë për të filluar punimet.



Lulzim Hasa . Unë jam anëtar i Këshillit Bashkiak unë nuk po kërkoj llogari pse ai nuk filluar punimet s'ka punësuar të tjerë. Se po të kishin filluar punimet dhe të marri ... ai ka pretenduar se ka marrë roje nga Bedeni që nuk është zona jonë. Kush është ky?

Artur Kaja . Asnjë roje nuk ka marrë.

Lulzim Hasa . Ka marrë, e ka mbajtur kot ndoshta. Turi në qoftë se komunikon t'i japë lekët burrit të huaj se ka fëmijë për të mbajtur se ka hyrë tek sistemi i ndihmës, ka dy binjakë një djalë të rritur nuk ka me çfarë t'i ushqejë. Unë i kam çuar mesazh atij, çfarë nuk i kam thënë. Doni ta lexoj këtu? Se kam turp, se kam frikë atë unë. Në mbledhjen e ardhshme Kryetare kërkoj që personi në fjalë të vijë të japë llogari këtu.

Mukades Gixhari . Mbledhjes ju bashkua dhe Këshilltari Erind Tosku. Znj. Fatmira fjala për ju.

Fatmira Thartori . Në lidhje me pyllin e Bedenit e kisha një pyetje për z. Artur. Kur jepen koncesione konkretisht pasuria e pyllit të Bedenit, ka nga Bashkia duhet të ketë nga Bashkia jonë një komision që e kontrollon këtë firmë apo çfarë është ky subjekt. Konkretisht si e keni menaxhuar ju gjatë kësaj periudhe për vitin 2022 këtë firmë? Si e keni kontrolluar, si e keni menaxhuar, gjithë situatën të ardhurat apo gjithë çfarë shpenzimesh ka kërkuar apo ka dhënë firma konkrete?

Artur Kaja . Atëherë nga momenti që është miratuar dhënia në përdorim kontrata është lidhur me 6 Dhjetor 2021 dhe nga ai moment deri tani firma nuk është koncesion por është dhënie në përdorim se koncesioni është një gamë më e gjërë, firma nuk ka kryer asnjë lloj punimi. Pse? Sepse në kontratë unë ja kam shënuar me të zeze, punimet do të fillojnë pasi të ketë marrë leje nga organet kompetente që do të thotë nga KRRT-ja e Bashkisë ose e Qarkut. Ai nuk e ka marrë atë leje akoma, në moment që ai ta marri sot, nesër ai do i paguajë lekët kokërr më kokërr.

Fatmira Thartori . Edhe njëherë, pra pyetja ime ishte konkrete. Si e keni menaxhuar ju si e ka menaxhuar Bashkia kontrollin ndaj këtij subjekti.

Artur Kaja . Tani në moment që është lidhur kontrata bëhet dorëzimi me procesverbal i zonës pyjore në prani të kemi qenë një grup prej 5 vetash nga Bashkia si zyrë pyjesh dhe subjekti, ka qenë i pranishëm edhe roja që kemi pasur.

Fatmira Thartori . A i keni lënë afate kësaj firme?



Artur Kaja . Jo nuk ka afate sepse ai afatet janë në dorën e tij do t'i shtojë ai që të fillojë punimet.

Fatmira Thartori . Pra edhe njëherë Luli tha që është hequr një punonjës.

Lulzim Hasa . Vetëm një kishte, atë e hoqi.

Fatmira Thartori . Dhe unë prap po pyes si e keni menaxhuar këtë pjesën e këtij pra është hequr a nuk është hequr sa punonjës ka, sa harxhime ka bërë?

Lulzim Hasa . Mund të ndërhyj një moment që ta lehtësoj ty. Në moment që u lidh kontrata me këtë person punonjësi që ishte i punësuar është kontraktuar në këtë kontratë? Se kështu është thënë këtu çdo njeri i punësuar do të punojë prap në atë pasuri dhe të tjerët kur të fillojnë punimet do merren prap nga ajo zonë është thënë këtu fjalë për fjalë.

Haqim Tosku . Lul këtu mund të jetë thënë por varet si e kanë lidhur kontratën këto. Nuk kemi të drejtë si Këshill t'i kërkojmë hesap firmës mos i ngatërroi gjërat.

Lulzim Hasa . Po të jetë lidh kontrata ai nuk ka si të luaj, po nuk ishte lidh kontratë ai tallet.

Haqim Tosku . Tur a ke kopje të kontratës aty? Sille ta lexojmë.

Lulzim Hasa . Kur është bërë ajo marrëveshje jam nga ajo zonë dhe kam thënë kështu, se kështu funksionon një objekt që privatizohet apo jepet në koncension njerëzit që janë aty punojnë akoma aty është taksative, këtë pikë kam bërë. Po, ka thënë Turi dhe kush e mbronte atë koncension. Dhe jo vetëm kaq ai që nuk mbajti këtë e hoqi, ai vjen sikur me qenë kapadaiu i zonës tangërlëku i madh, sikur ka çliruar gjithë zonën atje e ka mbjellë baba i tij. Kujt i bën këtë sfidë ky? E votojmë ne këtë në Këshill Bashkiak nuk e voton zotëria...

Haqim Tosku . E kaloi lumin ai.

Lulzim Hasa . Prandaj unë kërkoj të vijë këtu të japi llogari.

Haqim Tosku . Luli ne duhet t'i kërkojmë llogari jo këtij, kryetarit të Bashkisë që t'i vejë para përgjegjësisë këto.

Artur Kaja . E thashë dhe njëherë ai akoma nuk ka filluar.



Lulzim Hasa . Turi unë po të ngrej një çështje konkrete, ta lejmë punën punëtorët e të tjerë nuk e kemi ne në tagrin të diskutojmë sot pse ai nuk ka filluar. Personi i punësuar e ke paguar ti ke mbi një vit e gjysëm i çoje listë pagesat siç çoj unë për mësuesit e mi, çoje ti për atë apo jo? A ke çuar?

Artur Kaja . Po po edhe marrëveshje me atë gojarisht është bërë që këto roje do rrinë...

Haqim Tosku . Harroje Turi marrëveshje gojore nuk ka, këto janë me kaluar rradhën.

Artur Kaja . Kontrata nuk përfshin marrëveshjet private me rojet. Ai thotë kështu, do punësohen njerëz nga zona.

Luan Sheshi . Nga A-ja tek ZH-ja nuk përfshin emrat po.

Haqim Tosku . Jo emra, numrin e punonjësve në qoftë se është lidhur kontrata je i detyruar por emra do i përzgjedhi ai se nuk do marri dembelët ai, do marri atë që i bën punën.

Artur Kaja . Luan edhe personi vetë ka qenë dakord që do t'i mbajë do t'i paguajë ...

Haqim Tosku . Ka gjë të shkruar? Lëre ka qenë kështu e ka qenë ashtu...

Artur Kaja . Është bërë një vit që ai nuk ka ardhur se do vijë tek ne.

Lulzim Hasa . Kryetare kemi një problem se personi në fjalë ka marrë atë ndihmën që kemi ne ka dy fëmijë binjakë nuk i ka djali një pesë lekësh t'i shkojë në shkollë. E di çfarë do të thotë kjo apo jo? Personi në fjalë ka diskutuar këtu që ai jo vetëm do e mbajë në punë nuk bëhet fjalë nga goja e Turit e kemi dëgjuar dhe taksative kështu është që duhet ta mbajë në punë. Kush do e ruajë atë pyll? Në qoftë se Turi atij do i thonte që ky person ka punuar një vit e gjysëm në Bashki dhe unë e kam paguar çdo muaj çoj listë prezencën ai duhet ta paguajë. Kush është ky?

Artur Kaja . Ashtu ka qenë fjala për ta paguar. Tani lekët atij asnjëri nuk do ja mbajë personit sepse ne kemi në dorë atë person që do vijë.

Lulzim Hasa . Pse duhet ta largojë?

Artur Kaja . Unë nuk e di se e ka larguar. Unë dje fola me Reshatin.



Lulzim Hasa . Po çfarë Reshati, kush është Reshati? Ai është një privat që shkon e rri... por nuk është paguar Reshati, është bërë pagesë?

Artur Kaja . Jo.

Lulzim Hasa . Nuk quhet ajo, një njeri që nuk merr pagën në këshillin bashkiak nuk është anëtar këshilli.

Artur Kaja . Luli të thashë dhe njëherë në moment që ai do marri lejen nga atje do vijë në Bashki edhe në moment që do e marri lejen nga ne atij nuk do i jepet leja pa bërë pagesën e personit.

Haqim Tosku . Ja nuk erdhi në Bashki më ai çfarë do i bësh?

Artur Kaja . Po do vijë ai se do fillojë punimet.

Haqim Tosku . Po do e marri në fund, nuk kryen punime.

Artur Kaja . Ai nuk e ka marrë për zbukurim pyllin e ka marrë për të bërë punë.

Lulzim Hasa . Vjen tallet një njeri me pronën tonë me qytetarët tonë sepse nesër atij do i kërkosh votat jo atij që ...

Artur Kaja . Ky problem do zgjidhet sepse atij nuk do i jepet asnjë lloj dokumentacioni.

Lulzim Hasa . Unë kam shumë për të thënë, unë kërkuj që të vijë këtu ai.

Artur Kaja . Do flasim prap bashkë ne që ai leje nuk do marri pa paguar... pastaj deri në këtë moment që ka roje mbrapa le të vendosi roje të tjerë çfarë të dojë.

Lulzim Hasa . Nuk ka faj ai se kam votuar unë për ta privatizuar ai atë, ti ke qenë këtu asnjë nuk ishte dakord, shkova të vejë vetulla nxorra sytë e mi.

Mukades Gixhari . E merr përsipër që ta zgjidhësh këtë problem?

Artur Kaja . Kryetare ai ka marr lejen për të bërë një aktivitet dmth ka gjetur objektin por nuk ka marrë lejen për ta mbushur këtë objekt.



Lulzim Hasa . Nuk mbahet 300 mijë lekëshi i rojes.

Luan Sheshi . Aktualisht sa sipërfaqe shfrytëzohet?

Artur Kaja . Nuk shfrytëzohet fare, ashtu si ka qenë ashtu është.

Haqim Tosku . Si i paguan lekët ai, pa bërë asnjë lloj pune?

Luan Sheshi . Aktualisht sipërfaqja që është dhënë me qera, kush e menaxhon sot e një vit?

Artur Kaja . E ruan ai me këto dy rojet që i ka gënjyer përditë t'i jap sot t'i jap nesër.

Lulzim Hasa . Ekziston mundësia e prishjes së kontratës? Hajde diskutojmë në këshill bashkiak jo se jam unë preken interesi im jo, se nuk është familja ime ajo.

Haqim Tosku . Luli që të diskutosh punën e kontratës duhet të hedhësh vendimin më përpara se ne nuk kemi të drejtë të lidhim kontratë ne nxjerrim me qera çfarë jepet truallin. Autoriteti është kryetari i bashkisë që lidh kontratën, nuk kemi të drejtë ne ta ndryshojmë duhet të hedhim vendimin poshtë të gjitha tokat që kemi dhënë ose pyjet që kemi dhënë me qera duhet me kthyer vendimin mbrapsht, duhet me ja marrë prap.

Lulzim Hasa . Këtë po them dhe unë.

Haqim Tosku . Po për faj të njërit të digjen të gjithë?

Lulzim Hasa . Po çfarë të ardhurash i sjell Bashkisë ai?

Haqim Tosku . Kështu thotë ai se unë ... unë këtë e pyeta pyetjen e parë kontratën i bëra.

Artur Kaja . Ai në moment që do marri leje nga KRRT-ja do fillojë punimet për ... kështu që ai nuk ka marrë lejen ...

Mukades Gixhari . Ka mundësi të flisni me radhë ju lutem? Z. Lulzim do e marri përsipër Arturi do e zgjidhi bashkë me kryetarin.

Artur Kaja . Këtë muhabet ne do e zgjidhim bashkë me kryetarin ...



Lulzim Hasa . Turi ka thënë kështu deri për vit të ri do jetë i likuiduar e kam këtu unë me të gjitha. Tani e ka fjalën për 2024 ai?

Artur Kaja . Kështu na kanë mashtruar të gjithë. Në qoftë se ai e mban atë pyll për të parë zogjtë.

Mukades Gixhari . Përgjegjësia i kalon direkt z. Artur. Jeni dakord të kalojmë në pikën tjetër?

Haqim Tosku . Edhe diçka tjetër ,atëherë të gjithë se pak a shumë dihet kjo periudhë kaloi. Të gjitha tokat që janë të zëna dhe të investuara pra a janë futur aty, a janë planifikuar? A janë thirrur personat që do marrin a s' do marrin? Se nesër ngrihem unë dhe kërkoh ta marr me qera këtë tokën por atë e ka zaptuar Ersilio dhe ai e ka bërë investimin. A janë thirrur këto persona që të mos ketë kontradikta mos kenë përplasje? Sepse të gjithë kanë zaptuar kodrat, mirë e kanë bërë që kanë investuar shumë mirë biles por ndoshta nuk di ai që duhet me ardhur me e marr me qera. Janë bërë këto veprime? Ne do i nxjerrim me qera të gjitha del një pronar i madh atje do e marr unë thotë, dakord edhe Këshilli Bashkiak nuk firmos se firmos Kryetari është i detyruar se të ardhura për bashkinë do edhe do i shfrytëzojë...

Luan Sheshi . Është bërë identifikimi?

Haqim Tosku . Ne mirë bëjmë që i nxjerrim por si do e bëjmë? Fillojmë dhe fusim njerëzit në sherr pastaj, a është bërë apo jo?

Artur Kaja . Nuk do jepet asnjë lloj sipërfaqeje që është e mbjellur nga ... në qoftë se ka pseudo pronarë jo pronarë por pseudo pronarë që e kanë zënë.

Haqim Tosku . Ato numra kadastralë që ke shkruar, i ke të gjitha bosh?

Artur Kaja . Po.

Haqim Tosku . S'ma do mendja.

Artur Kaja . Tani...

Haqim Tosku . Tani ose jo ose po dy gjëra ka, jo një çikë.

Artur Kaja . Ne nuk kemi dalë akoma tek ky jemi tek i pari.



Haqim Tosku . Po mirë njëlloj është ajo tek plani, ndërveprim dhënie me ... po ai material është.

Artur Kaja . Jo, po vazhduam tek ky atëherë...

Mukades Gixhari . Kemi dhe pikën tjetër pika 7- të, Shqyrtim dhe njohje të Projekt- Studimit, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor, tokave bujqësore dhe inproduktive (PF) në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Rrogozhinë”. Z. Artur sërish fjala për ju.

Artur Kaja . Atëherë projekt studimi është bazuar në studimin që është bërë për pyjet dhe për tokat bujqësore dhe inproduktive të refuzuara. Për sa i takon pyjeve nuk mund të fus me zona kadastrale sepse pylli i Rrogozhinës nuk ka pronarë edhe ...

Haqim Tosku . Kush tha që nuk ka pronarë?

Artur Kaja . Nuk ka pronarë...

Haqim Tosku . Nuk e di ti por e di unë që ka pronarë.

Artur Kaja . Po të kish të pasur pronarë kish të paraqitur çdo njeri dosjen.

Haqim Tosku . Janë analfabetë nuk dinë të shkruajnë, si nuk ka pronarë? Ka gjë pa pronarë? Ato po i dalin pronarë detit nuk i dilkan pyjeve të Rrogozhinës mos ja fut kot.

Artur Kaja . Po të kish të dalë, kish të dalë ai tani.

Haqim Tosku . Po ka po të them unë atje ku e ke planifikuar ti, kam unë tokën e gjyshes, gjyshit mos flisni kot. Unë këtë identifikim kërkova, çfarë po kërkuj. Ti po thua plani për këtë vit duhet me bërë letrat i kërkujnë lart, mirë në rregull.

Artur Kaja . Ky projekt studim bëhet çdo vit. Ajo parcelë që jepet me qera do shikohet tek zyra e regjistrimit në qoftë se nuk ka pronarë do jepet me qera, pse bëhet regjistrimi i pasurive përpara. Bëhet regjistrimi në qoftë se është shtet do jepet me qera në qoftë se nuk është shtet...

Haqim Tosku . Këtu po bëhet fjalë për tokat e lira jo ato që janë regjistruar në hipotekë. Se në hipotekë kërcet pushka aty, unë po them këto të lirat.

Luan Sheshi . Më fal ndodh kjo... kjo do hidhet si material online është i interesuar filani. I keni identifikuar ju që këto janë pa ...?



Artur Kaja . Luan ky material nuk do hidhet online. Studimi do bëhet për çdo parcelë në veçanti ... Projekt studimi nuk hidhet online, ky është një projekt studim...

Haqim Tosku . Po do kalojë në vendim pra.

Artur Kaja . Procedurat për dhënien me qera pastaj janë me prokurim publik.

Luan Sheshi . Jam i interesuar unë pasi shikoj këtë, këtu tani ka konflikt interesi?

Haqim Tosku . Sa të duash. Unë përse e kërkova identifikimin përpara se të bësh atë. Nuk jam dakord të kalojë.

Artur Kaja . Luan ne këtu kemi vendosur edhe sipërfaqen që e ke ti me qera, që kam biseduar me ty që e ke mbjellë më fal jo me qera që e ke mbjellë me ullinj do ta mbash po ti nuk është problemi që ne këtu atë që ke mbjellë ti do të ja japim tjetrit apo tjetrit.

Haqim Tosku . Por ti nuk e ke identifikuar.

Luan Sheshi . Jam në një linjë me Haqimin e kam thënë më përpara do na ndodhi kjo. Ky material unë jam i interesuar si sipërmarrës ...

Haqim Tosku . Ashtu siç janë hapur fjalët që nga Sinaballaj e të gjithë e ka marrë Argita, ja fusin një kot e më kot.

Luan Sheshi . Jam i interesuar futem tek faqja e Bashkisë gjej këtë material edhe do vi të negocioj për sipërmarrjen e këtij ...

Haqim Tosku . Ai që është i interesuar sheh pikat e hartës aty dhe thotë po shkoj t'i marr unë.

Luan Sheshi . A ka konflikt interesi në të gjithë këtë identifikimin që keni bërë ju...?

Haqim Tosku . Sa të duash.

Luan Sheshi . Përplasje për nesër?

Artur Kaja . Ky identifikim nuk është ai që vendos ...



Luan Sheshi . Mund ta ketë mbjellë ullinj ai Turo nuk ka bërë letrat.

Artur Kaja . Po pra ai që ka mbjellë ullinj do ta marrë ai atë ...

Haqim Tosku . Po ai që nuk e ka mbjellë fare e ka shkurre?

Artur Kaja . Në qoftë se është tokë e tij le ta mbajë.

Haqim Tosku . Si do e mbajë, ku e di ti se kujt i është?

Artur Kaja . Si do e marri me qera ai kur e ka me shkurre?

Haqim Tosku . Je i kthimit të pronave ti? Ti do me dhënë me qera tokat bosh, po identifikimin kush ka pronë aty ti nuk e dinë në radhë të parë, kush ka mbjellë ti prap nuk e dinë. Afatin e ke vënë 10 vjet, ai që do mbjellë nuk do mbjellë ullinj për 10 vjet se do e mbjellë për 50 vjet.

Artur Kaja . Duket se e keni ngatërruar atë leximin sepse baza ligjore për 10 vjet është për pyjet, pastaj kur fillojmë me dhënien në përdorim të tokave bujqësore ka afat tjetër.

Luan Sheshi . Pak rëndësi ka koha ne themi ka premisë për të pasur nesër konflikt...? Apo i keni unifikuar me zëra kadastralë.

Artur Kaja . Dhënia e tokave bujqësore i ke ligjet këtu poshtë i ke këtu nuk i ke për 10 vjet i ke po të lexosh këto udhëzimet tani unë nuk do shkruaj të gjithë udhëzimet të gjitha ligjet ...

Haqim Tosku . Ti shkruaji se dhe unë po të them ty çfarë thotë ky ligj as ti as unë nuk e di, se unë se kam lexuar atë ligj.

Artur Kaja . Unë i kam lexuar të gjitha.

Haqim Tosku . Në rregull por nuk je në gjendje të ma thuash këtu tani, se ashtu ta marr librin e lexoj dhe unë. Zotëri a je në gjendje të më japësh përgjigje me tokat e Rrogozhinës nuk po them vende të tjera se në të gjithë bashkinë ka. Atëherë e keni identifikuar sa tokë është e lirë, sa është e zënë dhe sa pretendojmë? - Jo. Do e hedhësh direkt në faqe zyrtare del nesër një dhe do ta marri të gjithë.

Artur Kaja . Nuk do hidhet e gjithë kjo. Kush do bëjë kërkesë...



Haqim Tosku . Do e bëj unë kërkesën për të gjithë Bashkinë.

Margarita Dedej . Pa marrë informacion si mund të kërkojë ai?

Haqim Tosku . Po nuk hodhe koordinatat ti si do kërkojë ai kur thotë Margarita.

Margarita Dedej . Në vazhden e diskutimit që kolegët parafolës po ngrejnë një shqetësim. A janë të identifikuar tokat që do jepen me qera? Sepse cilido nëse shfaqet në fletoren zyrtare duhet të ketë informacion në filan parcelë në filan vend është një tokë me qera dhe pastaj i interesuari e shikon ka mundësi investimi atje. Në materialet mendoj që ju na keni paraqitur ka informacion jo të qartë edhe ju vetë mund të sqaroni për pikat që kolegët parafolës i ngritën me shqetësime të mëdha. Ky është mendimi im nuk e di nëse kanë ndonjë gjë tjetër kolegët për të shtuar le të bisedojmë dhe le të flasim.

Artur Kaja . Pjesa më e madhe janë bazuar tek kërkesat e fermerëve që kanë ardhur këtu për pronën dhe ne kemi shënuar çfarë parcele je ti? -Këtë. Këtë parcelë kemi futur për të dhënë me qera, që nesër pasnesër ai ...

Haqim Tosku . O Tur mos e zgjat muhabetin se sa më shumë të flasësh aq gabime bën. Në qoftë se niset kush vjen e kërkon edhe e identifikon është gabim, se Bashkia ka 365 punonjës, ka dhe 40-50 kryepleq edhe nuk bënka dot identifikimin e caq hektarëve tokë, tani mos ja fusim kot, mos fol më shumë caq.

Artur Kaja . Nuk e di më shumë a më pak por zotëri lexoni ligjin ai thotë...

Haqim Tosku . Të lutem më jep përgjigje ndryshe nuk kalon.

Artur Kaja . Zotëri mua nuk më interson e kalon se kalon.

Haqim Tosku . Jep përgjigje mësove si ajo puna e recetave të gatimit të peshkut.

Artur Kaja . Unë këtë projektstudim e paraqis për banorët e kësaj zone sepse ato janë të interesuar.

Haqim Tosku . Po ky zotëria thotë do hidhet atje, dëgjoje.

Mario Meka . Në moment që kalon me vendim të këshillit bashkiak çdo gjë që kalon shkon tek vendime.al.



Artur Kaja . Çfarë është ky projektvendim apo projektstudim? Nuk është projektvendim...

Haqim Tosku . Dëgjoje... projekt dhe do kalojë në vendim. A do kalojë në vendim?

Mukades Gixhari . Sot është për njohje.

Artur Kaja . Nuk kalon në vendim është për njohje. Pastaj në qoftë se do ketë kërkesa atëherë do vijnë këtu dhe do thuhet në filan zonë ka kërkesë nga Luani, jeni dakord ta japim në përdorim, po apo jo?

Avni Kasa . Për këto që kanë mbjellë ullinj është?

Artur Kaja . Po. Ai që ka mbjellë dhe ai që nuk mbjellë që është bosh.

Avni Kasa . Kë pyeti ai që mbolli ullishte, e zabtoi tokën ai?

Haqim Tosku . Po mirë bëri që mbolli.

Artur Kaja . Tani ai e ka mbjellë ullinj, të ja prishim ai e ka mbjellë ka 20 vjet që e ka mbjellë.

Fatmira Thartori . Ai e ka mbjellë tek toka e babës toka e nënës një pjesë.

Mukades Gixhari . z. Agim Pepa.

Agim Pepa . Unë kam këtë kryetare, së pari këshilli me kaq autoritet bashkie kaq pak këtu, vetëm këshilli me 2 zyrtarë bashkie nuk shkon njëherë, e para kjo tregon që... Dhe këto shqetësime që ngrejmë të gjithë ne këtu për hapësirën pyjore, fondet kullosore pyjore çfarë janë... janë shqetësimet e të gjithëve t'i marrim me respekt këto gjëra sepse po katandiset shteti, bashkia siç i kanë zënë njerëzit tokat sipas dëshirës edhe shteti jep tokën sipas dëshirës ku ka bosh thotë ai. Pse kjo është llogjika e shtetit? Po nuk është kjo llogjika shtetërore. Dhe kjo tregon...

Artur Kaja . Po tokat që janë bosh do jepen.

Agim Pepa . Po pra po por nuk flet shteti kjo është bosh do e marr unë.

Artur Kaja . Jo ta marr unë, ta marri ai që plotëson kushtet.



Agim Pepa . Nuk flet shteti kështu sepse ai që ka mbjellë në Okshtun atje, flasin njerëzit atje thonë që nuk vazhdon më nga Hemenraja se kanë dalë njerëzit thonë që është e imja po ashtu dhe nga Kryeluzaj nga pjesa që vazhdon andej poshtë. Ky është regjimi i punës që duhet të bëjmë ne aty? Kaq kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Agim. z. Lulzim Hasa.

Lulzim Hasa . Përderisa kjo nuk është projektvendim për çfarë zgjatemi?

Mukades Gixhari . Është për njohje.

Lulzim Hasa . Ja u njohëm. U njohëm keq u njohëm mirë, kur të vijë projektvendimi ...

Haqim Tosku . U njohëm diskutuam mirë bëmë këto t'i sjellin këto të dhënat kaq.

Lulzim Hasa . Edhe e kundërshtojmë.

Haqim Tosku . Jo e kundërshtojmë nuk kemi pse e kundërshtojmë ne. Në qoftë se është identifikimi i saktë dhe të gjitha pse do e kundërshtojmë ne.

Lulzim Hasa . Derisa kjo ishte për njohje ne u njohëm, sugjerimet tona i thamë.

Haqim Tosku . Shumë dakord, normalisht duhet të kalojnë të gjithë të nxjerrin në përdorim normale me qera.

Artur Kaja . Haqim edhe diçka nëse më lejoni. I njëjti material është paraqitur edhe vjet këtu ka qenë edhe pylli i Bedenit për t'u dhënë me qera...

Haqim Tosku . Mësove si një shef zyre këtu që thotë vetë e keni miratuar vjet ju.

Artur Kaja . Një sekondë ...

Haqim Tosku . Kështu tha ai vetë e keni miratuar vjet ju tha, edhe ti të njëjtën punë po bën. Po mirë pse u bë gabim vjet duhet të vazhdojmë ta bëjmë gabim.

Artur Kaja . Prit të shprehem se unë nuk kam mbaruar shprehjen akoma. I njëjti projektstudim ka qenë dhe vjet ka pasur pyllin e Bedenit këtë vit e kam hequr sepse u dha me qera kaloi në



Këshilli ai nuk kaloi me anë të këtij kaloi nga ana jonë pasi u paraqit në Këshill apo jo? Ky projektstudim tani u hoq pylli i Bedenit se është dhënë me qera, ja tani këtë vit do jepen 2-3 parcela do hiqet vitin tjetër nga studimi tjetër, kështu është kjo, ky është projekt për njohje nuk është që vendos. Ajo tokë që do jepet me qera do kalojë në duar tuaja prap, do jepen me vendim Këshilli.

Fatmira Thartori . Jemi dakord me atë por siç ka bërë këshilli paraardhës që dha gjithë tokat e Okshtunit ne nuk duhet të bëjmë atë gabim që bënë ato. Janë tokat tona ato, janë zënë tokat tona atje nuk quhen më të tonat, sepse e ka marrë tjetri e ka marrë me dokumente nuk quhet më prona ime. Kështu që edhe për këtë pronën që unë do ngre dorën këtu vjen tjetri prap ma merr pronën mua. Po pse çfarë bëjnë gjithë këto punonjës të bashkisë që ju i keni në varësi drejtoria juaj, çfarë bëjnë nuk i identifikoni dot ju ku është mbjellë kjo parcelë, cila parcelë është bosh? Dhe këto pyesni në Bashki aty në komunë ...

Artur Kaja . Cili nga ato persona që është dhënë me qera është cënuar nga ato, gjithë veç e kanë.

Fatmira Thartori . Prona e Astrit Thartorit është marrë.

Artur Kaja . Astrit Thartorit?

Fatmira Thartori . Po është marrë .

Artur Kaja . E kush e ka marrë me qera atë?

Fatmira Thartori . Ai që e mori tokën e Okshtunit.

Haqim Tosku . Turi gabim nuk ke të drejtë të diskutosh me emra të përveçëm mos kalojmë në gjëra private.

Fatmira Thartori . Këtu është prekur e imja prandaj të pyeta.

Artur Kaja . Zonja po fliste për Gërmenjin.

Fatmira Thartori . Për Lekajn, Okshtunin. A është marrë?

Artur Kaja . Po.



Fatmira Thartori . Prona ime është aty brenda është e zotërisë tjetër tani nuk është më pronë ime dhe si pronë e tim shoqi ka edhe të tjerë.

Artur Kaja . Ka pronë të veçantë secili dy tre persona që janë.

Fatmira Thartori . Zotëri identifikoni personat që kanë këto sipërfaqe sepse të gjithë ato sipërfaqe atje janë të zëna janë të mbjella me ullinj, kështu që i identifikoni pastaj na i jepni gjërat konkrete këtu. Mos ecni jo e ka bërë ky vjet jo e ka bërë ai.

Artur Kaja . Ky ishte projekt për njohje nuk ishte për vendosje as për ta kaluar në Këshill për ta miratuar me vendim.

Mukades Gixhari . Z. Artur mbaruar. Vazhdojmë me pikën 8-të, të ndryshme, Shqyrtim të kërkesës së znj. Zaje Hunçi. Fjala për Kryetarin e Komisionit të Posaçëm të tërmetit z. Mario Meka.

Mario Meka . Zonja ka kryer një ankesë që, e para punës ka gënjer sepse ka thënë që është DS2 dhe unë kam me kontratë me të gjitha që ka përfituar DS3. Ajo ka thënë ka nisur themelet por përfitimi i DS3-it është që merret leje rikonstruksioni jo leje ndërtimi. Ne kemi bërë dhe vendim që i është çuar po me postë zonjës që ka përfituar DS3 dhe brenda 5 ditëve... praktikisht nga ana e Bashkisë është kryer çdo gjë ligjore, ajo nuk ka ardhur dhe i ka prishur ato që janë në Lekaj e dinë më mirë si muhabet por praktikisht nga Bashkia nuk kemi çfarë t'i bëjmë asnjë gjë. Se bëhet fjalë kontrata është 16.07.2020.

Agim Pepa . Ti e di atë punë.

Haqim Tosku . Komisioni si e ka vlerësuar në atë kohë?

Mario Meka . Me DS3.

Haqim Tosku . Po pse nuk mund të bënte ai komisioni kur e pa gjendjen aq të dobët nuk mund të bënte se ka bërë lloj lloj ndryshimi nuk mund të ja bënte asaj DS5?

Mario Meka . Nuk e shikojnë komisioni këtë e shikojnë inxhinierët.

Haqim Tosku . Po inxhinierët.



Mario Meka . Ne i kemi çuar vendimin dhe tek vendimi pika tretë thotë, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim.

Haqim Tosku . Pra dërgimi juaj vjen, konstatohet nga inxhinierët atje.

Mario Meka . Jo vendimin tonë e kemi çuar ne me postë, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi dmth nga letra mund të vinte në Bashki të ankimonin, praktikisht nuk ka ardhur asnjë. Këto mesa di unë nga brenda është gënjyer me firmën e ndërtimit se i ka thënë me 5 milion do të bëjmë shtëpi dhe i kanë prishur muret dhe ja kanë lënë muret po ashtu. Është marrëveshje që ka bërë ajo me firmën vetë.

Avni Kasa . Unë e kam komshije atë, asaj i kanë mbetur vetëm muret erdhi firma i hoqi çatinë mbaruan lekët 5 milionëshi dhe ja la përgjysëm, biles ka dhe paletën me çimento aty. Ajo ka mbetur në katër rrugë, çfarë mund të bëjë Bashkia?

Mario Meka . Jo nuk kemi çfarë t'i bëjmë unë u habita me kërkesën e saj por është e drejta e asaj.

Avni Kasa . Mario ajo ka përfunduar në atë llum që themi Bashkia çfarë mund t'i bëjë? Vijnë ta verifikojnë atje ta shohin.

Mario Meka . Bashkia nuk ndihmon dot me 10 milion lekë të vjetra.

Avni Kasa . Ajo fle rrugëve andej nëpër miq është e drejtë ajo që ka shkruar aty.

Fatmira Thartori . A ka mundësi Mario që kjo të futet prap të bëjë një kërkesë dhe të futet prap tek tërmeti?

Mario Meka . Nga ana e tërmetit jo.

Avni Kasa . Është gjynah është me një vajzë.

Haqim Tosku . U bë 4 vjet që ka rënë tërmeti.

Mario Meka . Nga ana e tërmetit kjo ... zyshe ajo ka firmosur kontratën ka marrë lekët me datë 16.07.2020.



Fatmira Thartori . Nuk mundeshit që ju t’i jepnit ndonjë këshillë zonjës me gjithë atë gjëndje të vështirë që është ajo prap pa bashkëshortin vetëm me një, që ajo ta refuzonte atë dhe të mernte tek pjesa tjetër? Në qoftë se ka pasur shtëpiat të prishura sikurse thotë edhe zotëria këtu.

Mario Meka . Zyshe ne e kemi çuar ankesën, është vlerësuar nga inxhinierët dhe ajo në qoftë se do kishte kundërshtime nuk është vetëm vendimi brenda 5 ditëve por ajo nuk duhet të firmoste kontratën nuk ishte dakord me firmos dhe nuk është dakord me shkuar tek posta të tërheqi lekët. Ajo i ka bërë të gjithë këto veprime, ka marrë dhe firmën se firmën nuk e lidh bashkia e ka gjetur vetë personalisht ajo.

Avni Kasa . Unë të kuptoj taman ty. Çfarë mund të bëjë Bashkia se është gjynah?

Mario Meka . Tani unë nuk jam as drejtori i financës as Kryetari i Bashkisë nuk jap dot përgjigje për këtë gjë nuk dal dot më sipër se tjerët.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër?

Fatmira Thartori . A ka banesa sociale?

Mario Meka . Jo.

Mukades Gixhari . Atëherë diskutime? Meqë nuk kemi diskutime të tjera mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit të gjithëve.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 00^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total : 50 min ; 11 sek).



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 27 (njëzet e shtatë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera